

VENDIM
Nr. 96, datë 24.2.1997

**PËR PAGESËN E TË PUNËSUARVE TË PORTIT DETAR TË DURRËSIT, TË
CILËT DALIN TË PAPUNË SI PASOJË E ZBATIMIT TË PROJEKTIT TË
RISTRUKTURIMIT TË KËTIJ PORTI**

(Ndryshuar me vendimin nr. 525, datë 8.7.2005)

(I përditësuar)

Për të rregulluar pagesat e të punësuarve të portit detar të Durrësit, të cilët dalin të papunë si pasojë e ristrukturimit të tij, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe të Ministrisë së Industrisë, Transportit e Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të punësuarit në Autoritetin Portual Durrës, të cilët dalin të papunë si pasojë e ristrukturimit dhe proceseve të privatizimit të sektorëve të ndryshëm të këtij porti, përfitojnë të drejtën e pagesës për një periudhë njëvjeçare, në masën 100 për qind të pagesës mesatare mujore, të vitit të fundit të punës, por jo më pak se paga minimale, në shkallë vendi, në çastin e shkëputjes nga puna.

2. Përfitojnë nga ky vendim të punësuarit në Autoritetin Portual Durrës, të cilët kanë qenë të punësuar në këtë Autoritet pa ndërprerje, për një periudhë kohe jo më pak se 1 (një) vit dhe vazhdojnë të jenë të punësuar në këtë Autoritet nga data 15.4.2005 deri më 21.10.2006.

3. Të drejtën e trajtimit nuk e kanë të punësuarit që largohen nga puna për shkaqe që nuk kanë lidhje me zbatimin e projektit të ristrukturimit të portit detar të Durrësit, si dhe ata që janë trajtuar një herë sipas kriterëve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.42o, datë 15.8.1994.

4. Fondet financiare për kryerjen e pagesave të punësuarve sipas këtij vendimi, duke përfshirë edhe sigurimet shoqërore për këta punonjës, do të përballohen nga Autoriteti Portual Durrës.

5. Periudha e trajtimit të të punësuarve sipas këtij vendimi konsiderohet vjetërsi pune për efekt pensioni dhe shënohet si e tillë në librezën e punës. Për të punësuarit e trajtuar me këtë pagesë derdhen të gjitha llojet e kontributeve, siç përcaktohet në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

6. Pagesat kryhen nga zyrat e punësimit të rretheve, duke u mbështetur në një dokumentacion që përcaktohet me udhëzim të veçantë.

7. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale të nxjerrin udhëzimin për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi